

Përqëndrimi

Te drejta

Liri

Detyrë

Obbligime  
DEMOKRACIA

Tolerancë



Respekt

Mirëqenie

**QEVERISJE QË SJELL  
ZHVILLIM**

## NE DHE DEMOKRACIA

ADONIS (11), TAMER (11), MARSIDA (11), LURA (11), VESA (11), OLTİ (11), ADI (12)



### Artikulli ynë përmban informata për demokracinë dhe tregon rolin që luajmë ne në demokraci

Keni dëgjuar ndonjëherë për demokracinë?


Çka është demokracia?

Demokracia është qeverisje e popullit. E populli qeverisë me anë të votimit. Demokracia ka lindur në Greqi gjegjësisht në Athinë, në vitin 507 p.e.s.


Elementet kryesore të demokracisë janë: toleranca, solidariteti, shprehja e lirë, barazia dhe paqja. Të gjitha këto elemente janë të rëndësishme dhe ne duhet të jetojmë në bazë të tyre. Në rast se dikush nuk pajtohet me mendimin tonë sepse mendon ndryshe, ne duhet ta mirëkuptojmë dhe ta tolerojmë atë. Mirëpo nëse ndodh që dikush të ketë nevojë për ndihmën tonë, ne duhet ta ndihmojmë dhe të solidarizohemi me të. Ne të gjithë duhet ti kemi të drejtat e barabarta dhe ta respektojmë njëri-tjetrin. Këto janë parime demokratike bazë dhe na ndihmojnë.

Kemi dy lloje të demokracisë. Ato janë përfaqësuese dhe e drejtpërdrejtë. Demokracia përfaqësuese është atëherë kur populli i zgjedh përfaqësuesit e vet. Kurse, demokracia e drejtpërdrejtë është kur populli direkt i merr vendimet për shtetin. Po ashtu, demokracia përfaqësuese ndahet në dy degë: presidenciale dhe parlamentare. Demokracia përfaqësuese parlamentare është kur Parlamenti apo Kuvendi ka kompetenca më të mëdha se Presidenti. Ndërsa demokracia përfaqësuese presidenciale është kur Presidenti ka kompeten-

ca më të mëdha se sa Parlamenti. Vendi ynë ka demokraci përfaqësuese parlamentare. Shteti ynë është shpallur vend i pavarur dhe demokratik më 17.02.08. Lexues të dashur, porosia jonë është që të gjithë të ndihmojmë njëri-tjetrin dhe të kemi mirëkuptim. Mos e harroni asnjëherë se demokracia është për të gjithë.



Gazetarët e artikullit




Këtu kemi paraqitur disa nga elementet e demokracisë



Malvesa duke shkruar disa fakte për ndarjen e pushtetit



E drejta për të shprehur afë që mendojmë përmes shkrimit



Edhe ti ke të drejtë!



E drejta për strehim



Bashkëpunimi po ashtu është element i demokracisë

# HAPI DREJT PËRMIRËSIMIT

DIARD (11), ART (11), BUTRINT (11), ERBLINA (11), ELENA (11), MENATA (11), VESA (11)

**Në këtë artikull mund të gjeni disa informata në lidhje me rëndësinë e qytetarisë aktive në një sistem demokratik**

Çdo njeri duhet të dijë të sillet mirë dhe të respektoj të tjerët në mënyrë që të bëhet qytetar i ndershëm, por edhe të kontribuoj për shtetin e tij.

Për t'u quajtur qytetar aktiv ne duhet të interesohemi dhe të marrim pjesë në aktivitete si në grupe të mëdha por edhe në grupe të vogla.


Qytetarë quhen të gjithë njerëzit të cilët banojnë dhe kanë leje qëndrimi në atë vend.

Toleranca është element i rëndësishëm për paqyrimin e kulturës së një vendi. Po ashtu çdo qytetar duhet t'u përmbahet dhe t'i kushtoj rëndësi të madhe përgjegjësisë së tij.

Me angazhim dhe vullnet të plotë ne të gjithë së bashku mund t'ia dalim.



Një foto e përbashkët e grupit punues



Në këtë vizatim janë paraqitur disa nga elementet e demokracisë si dhe disa nga të drejtat tona



Ne si qytetarë aktiv duhet ta ruajmë ambientin në të cilin jetojmë



Ne i ndihmojmë njëri-tjetrit



Fëmijët aktiv

## KUVENDI, QEVERIA DHE GJYKATA

BLERTI (12), MALVESA (11), LENDI (11), YLLI (11), ZGJIMI (11), ERBLINA (11), ERNEA (11)



**Ne, gjatë punëtorisë së demokracisë biseduam rreth ndarjes së pushtetit në një vend demokratik. Gjatë këtij artikulli ju mund të lexoni njohuritë dhe faktet të cilat ne i fituam sot**

Biseda jonë filloi me diskutimin mbi demokracinë. Demokracia është udhëheqja apo sundimi i popullit. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke, ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratos“ do të thotë udhëheqje. Së pari demokracia është shfaqur në Athinë. Athinasit fillimisht merreshin vesh drejtpërdrejtë, kurse më vonë me anë të përfaqësuesve të vendit. Kështu u zhvillua demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Me kalimin e kohës demokracia është përhapur në shumë shtete të tjera e jo vetëm në Greqi.

Në Kosovë punojnë disa institucione demokratike, të cilat ndahen në tri degë. Ato janë: dega Legjislative, dega Ekzekutive, dega Gjyqësore. Kuvendi është institucioni më i lartë legjislativ. Në Kuvend punojnë deputetët, të cilët janë përfaqësues të qytetarëve të Ko-


sovës. Kuvendi miraton ligjet. Miratim do të thotë kur një ligj pranohet me shumicën e votave të deputetëve. Në Kuvend janë 120 deputetë. Së pari, ndihet nevoja për një ligj të ri. Pastaj bëhet një debat ndërmjet deputetëve. Pas bisedës së deputetëve, ligji votohet dhe në fund miratohet. Nëse ligji nuk i përmbush të gjitha kërkesat e qytetarëve, ligji mund të ndryshohet pjesërisht ose tërësisht.

Dega ekzekutive përfaqësohet nga Qeveria, Presidenti, Policia dhe FSK. Qeveria zbaton ligjet të cilat miratohen nga Kuvendi. Në Qeveri punojnë ministrat, kryeministri, zëvendëskryeministri dhe zëvendësministrat. Gjykata ka detyrën e vendosjes së drejtësisë dhe është dega gjyqësore. Çdo njeri i akuzuar për një vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia. Kemi tri lloje të gjykatave: Gjykata Themelore, e Apelit dhe Supreme.

Ne mendojmë se punët duhet ndahen sepse kështu është më mirë për secilin qytetar të Kosovës.



Gazetarët e këtij artikulli



Pema e pushteteve



## IMPRESUM

demos ti

Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga

# TOKA

Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrur pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Emin Duraku“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë